

- 2 Dita ndërkombëtre e punëtorëve**  
**1. maji 2018 në shenjë solidariteti dhe me kërkesa për barazi**
- 3 Aktivitete për barazi në paga**  
**Duhet dhënë fund diskriminimit të grave në paga**
- 4 Dialogu për të drejtat e disaporës**  
**Nga 17–20 maj në Prishtinë u zhvillua konferencë katër ditore**

Nr. 3 | maj 2018 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

## Për dinjitetin dhe të drejtat e punëtorëve të ndërtimtarisë Me 23 qershor: Të gjithë në demonstratën e madhe të ndërtimtarisë!



Pamje nga demonstratat e punëtorëve të ndërtimtarisë për mbrojtjen dhe avancimit e të drejtave të tyre

**Në fund të vitit skadon Kontrata Kombëtare e Punës (KKP) për ndërtimtarinë kryesore. Gjithçka vihet në pyetje: Shoqata e punëdhënësve sulmon frontalisht KKP dhe pensionimin me 60 vjet. Sipas punëdhënësve, punëtorët e ndërtimtarisë duhet të punojnë më gjatë, të fitojnë më pak dhe të marrin pension edhe më të vogël: Kundër kësaj demonstrojmë ne me 23 qershor në Cyrih!**

Ka vite që të hyrat në ndërtimtarinë shtohen, librat e porosive janë përplot dhe fitimet e firmave rriten. Nuk është për tu çuditur: Gjithnjë e më pak punëtorë ndërtimtarie, ndërtojnë gjithmonë e më shumë. Për çdo ditë punëtorët e ndërtimtarisë bëjnë punë të rëndë në të ftohtë e në vapë, nën stres dhe presion terminësh. Për çdo ditë rrezikojnë shëndetin e tyre. Gjithnjë e më shumë shtohet numri i ndërmarrjeve nënkontraktuese dhe numri i të punësuarve të përkohshëm sa vjen e shtohet. Ndërsa punëdhënësit edhe përkundër shtrenjtimit e jetesës, kanë refuzuar çfarëdo rritje pagash.

Në fund të 2018 skadon KKP për ndërtimtarinë kryesore. Andaj sindikatat i janë reshtur punës për të negociuar një KKP të re. Dhe shumëçka vihet në lojë.

**Mungese respekti karshi punëtorëve të ndërtimtarisë**  
 Kontrata Kombëtare e Punës është vendimtare për punëtorët e ndërtimtarisë. Ajo rregullon pagat dhe kushtet e punës në ndërtimtarinë. Pa këtë kontratë kërcënon dumpingun në paga dhe kaosin. Andaj punëtorët e ndërtimtarisë

kërkojnë bashkë me Unia një kontratë të mirë Kombëtare të Punës, e cila i kushton rëndësi problemeve në ndërtimtarinë: Mbrojtje nga dumpingu në paga, masa kundër përqesimit të punës dhe përsëri më në fund një rritje pagash prej 150 frangave për të gjithë.

Por, në vend se të merren seriozisht kërkesat e punëtorëve të ndërtimtarisë për më shumë mbrojtje dhe rritje korrekte të pagave, shoqata e punëdhënësve planifikon sulm radikal ndaj kushteve të punës. Fillimisht kryetari i shoqatës së punëdhënësve, Gian-Luca Lardi dëshiron tu ulë pagat e punëtorëve të ndërtimtarisë: veçanërisht punëtorët e mos-huar të ndërtimtarisë dhe shërgjertët të fitojnë më pak. Pasi, gjoja ata «nuk kontribuojnë mjaftueshëm». Pos kësaj padroni Lardi dëshiron që të rrit orarin e punës në 50 orë në javë. Pra, të punohet më gjatë për më pak pagë.

### Duart larg nga pensioni me 60 vjet

Mirëpo, si duket kjo s' u mjafton – punëdhënësit përsëri sulmojnë pensionimin me 60 vjet. Sikur edhe para 3 vjetësh, punëdhënësit

duan përqesim radikal të pensionimit të mëhershëm. Konkretisht: Pensionim me 62 vjet apo 30% më pak pension.

Që nga fuqizimi i pensionimit të mëhershëm (FAR) me 2003 u mundësua që 17000 punëtorë ndërtimtarie pas punës së rëndë shumëvjeçare të shkojnë me dinjitet në pension. Përpara vetëm 1/5 e punëtorëve të ndërtimtarisë arrinte shëndetshëm moshën e pensionimit. 80% e punëtorëve të ndërtimtarisë janë të shtyrë në invaliditet, papunësi apo jashtë profesionit.

Pasi në vitet e ardhshme pensionohet gjenerata me lindje numerike, Fondit për pensionim të mëhershëm i nevojiten më shumë para. Mirëpo kjo vetëm deri në vitin 2014, më pastaj zbrit përsëri numri i pensionistëve. Pra, punëdhënësit marrin këtë si shkas, për të sulmuar fronta-

lisht pensionimin e mëhershëm: pensionim me 62 vjet (gjithsejtë 120000 franga më pak pension) apo 30% ulje pensioni (rreth 1500 franga në muaj më pak).

Punëdhënësit nuk e kanë pranuar pensionimin e mëhershëm të punëtorëve të ndërtimtarisë asnjëherë. Si më 2002, 2015 apo edhe tani: Punëtorët e ndërtimtarisë çdoherë duhet të luftojnë për pensionin e tyre.

### Bashkërisht në rrugë

Punëtorët e ndërtimtarisë janë të zemëruar. Me të drejtë! Dhe ata janë të gatshëm që të luftojnë për të drejtat e tyre. Pasi, kushdo që sulmon KKP dhe pensionimin me 60 vjet, sulmon dinjitetin e punëtorëve të ndërtimtarisë. Andaj ne do të demonstrojmë me 23 qershor në Cyrih: për një KKP të mirë, për pensionim me dinjitet, për paga korrekte!

Katja Signer und Chris Kelley

### Demonstrata e madhe e ndërtimtarisë: Marshimi për tek shoqata e punëdhënësve!

E shtunë, 23 qershor 2018 në Cyrih

Udhëtimi i përbashkët nga regjioni yt ose tek vendtakimi «Central» në ora 12.00

Të gjitha informatat për demonstratë si dhe për udhëtim falas) nga regjioni yt mund ti marrësh tek sekretariati yt i Unia, apo në: [www.unia.ch/lmv2018](http://www.unia.ch/lmv2018)

## Editorial



### Të dashur/a lexues/e

Këtë vit fjala është për gjithçka! Ne bashkërisht do të kundërshtojmë arrogancën e punëdhënësve – ka 37 vite që barazia në paga është e garantuar me kushtetutë, mirëpo gratë edhe më tej në muaj fitojnë mesatarisht gati 600 Franga më pak! Në total shefat kursejnë në kurriz të grave për çdo vit 7,7 miliarda franga! Mjaftë është mjaft – ne gratë tani duam pagën që na takon. Ne duam drejtësi! Prandaj duhet të kontrollohen pagat në të gjitha ndërmarrjet dhe nëse shefat e thyjnë kushtetutën dhe anashkalojnë të drejtat e grave, duhet të paguajnë dënime të majme. Pasi, nëse unë voziti kur semafori është në të kuqen, unë gjobitem, kjo duhet më në fund të vlejë edhe për barazinë në paga. Për mua është e qartë, pa presionin tonë nuk ndodhë asgjë – zotërinjtë politikane kundërshtojnë që të përmirësojnë ligjin, për të arritur gratë të realizojnë të drejtat e tyre. Paso, nëse ne diçka kemi mësuar në këto 37 vite, atëherë atë se vullnetarizmi nuk funksionon. Mjafton më! Me 14 qershor ne të gjithë i bashkohemi ditës së aksionit dhe me 22 shtator të gjithë ne bashkë shkojmë në demonstratën e madhe në Bernë për barazinë në paga dhe kundër diskriminimit.

Këtë vite bëhet fjalë për gjithçka – edhe në ndërtimtarinë. Punëdhënësit atakojnë pensionimin me 60 vjet – dhe atë, edhe pse kjo e arritur e madhe është e domosdoshme për të gjithë punëtorët e ndërtimtarisë, për shëndetin e tyre dhe shijimin e jetës në moshë të shtyrë. Pos kësaj ka vite që punëdhënësit kundërshtojnë më shumë pagë për punën e rëndë dhe të vështirë të punëtorëve të ndërtimtarisë. Ko është e padëgjuar! Andaj, këtë vit të gjithë ne bashkë me punëtorët e ndërtimtarisë do të shkojmë në demonstratën e 23 qershorit në Cyrih.

Eja edhe ti – ne llogarisim në ty. Pasi të bashkuar ne jemi më të fortë dhe arrijmë sukses!

Corinne Schärer

## News

## Mashtuesit e përfitimit social nuk do të dëbohen

Që nga zbatimi i iniciativës dëbuese të huajt që keqpërdorin marrjen e përfitimeve sociale humbin të drejtën e qëndrimit. Për këtë duhet të krijohet një ligj i ri, që ketë shkelje faktike e bënë të dënueshme. Deri më tani kjo ende nuk është bërë. Se sa të kallëzuar edhe në fakt janë dënuar, ende nuk është e njohur. Enti federal për statistika do të publikojë këto shifra në qershor. Në rastet e pakta të njohura deri më tani, janë ndërmarrë gjopa apo dënime me kusht. Mirëpo për keqpërdorim të tillë, ende nuk është dëbuar askush, edhe pse këtë e kërkon iniciative dëbuese. Arsye për këtë është edhe klauzola e rasteve të vështira, e futur nga qeveria federale dhe parlamenti.

## Kujdesi duhet të ngritet në këmbë

Me 12 maj, ditës së sivjetme ndërkombëtare të kujdesit, punonjësit e kujdesit dhe përkrahjes bashkërisht me sindikatën Unia kërkuar ndërmarrjen e masave efektive kundër mungesës së personelit dhe stresit të madh. Në Bernë me 12 maj 2018 rreth 50 persona vunë një shenjë të rëndësishme për kushte të shëndosha të punës dhe për një lëvizje të fuqishme sindikaliste.

## Nespresso: Personeli kundërshton përkeqësimet siguruarve shërbim me SMS

Nespresso ka paralajmëruar përkeqësime në tri vendndodhje të Zvicrës perëndimore. Personeli refuzon këtë dhe ka autorizuar Unia-n që të negociojë. Nespresso deri më tani ka refuzuar dialogun. Unia kërkon fillimin e menjëhershëm të bisedimeve.

## Sindikatat protestojnë kundër shkeljes së fjalës nga ana e LafargeHolcim

Të punësuarit/et dhe sindikalistët/ët në mbledhjen e përgjithshme të LafargeHolcim kërkuar mbrojtje më të mirë të punëtorëve. Korporata duhet të mbajë fjalën e dhënë dhe të nënshkruajë kornizë-marrëveshjen globale. Para aksionarëve, në një aksion proteste në Cyrih, të punësuarit e LafargeHolcim bënë me dije rastet e shumta të mosrespektimit të sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit në punë. Vetëm në 2 vitet e fundit gjatë punës për gjigantin zviceran të çimentos kanë humbur jetën më shumë se 150 njerëz. Edhe më shumë njerëz gjatë aksidenteve në punë kanë pësuar lëndime të rënda.



## 1 maji 2018: fuqizimi i solidariteti

## 1 maji në shenjë solidariteti dhe me kërkesa për barazi

Që nga viti 1889 në gjithë botën shënohet 1 maji. Edhe sivjet për një maj punë-marrësit e punëkërkuarit, sindikatat dhe grupet e organizatat përparimtare protestuan gjithandej nëpër botë për kushte më të mira pune, për paga dinjitoze e barazi pagash mes burrave e grave, për ndarje më të drejtë të pasurisë dhe të mirave shoqërore si dhe për një jetë më të drejtë, më të mirë e më të barabartë për të gjithë njerëzit, pa shtypje, pa shfrytëzim dhe pa luftëra.



## 1 maji në Zvicër

Në gjithë Zvicrën, në ditën ndërkombëtare të punëtorëve, dolën me dhjetëra mijëra në rrugë. Nën moton «Barazi në paga. Pikë. Fund!» kërkuar veçanërisht dhënies fund të diskriminimit skandaloz në paga! Gratë fitojnë rreth 20% më pak se burrat. 37 vite pas ankorimit të parimit kushtetues «pagë të njëjtë për punë të njëjtë», barazia e pagave duhet të kalojë në vepër. Për Gjithandej nëpër Zvicër me këtë kërkesë u ushtrua presion me 1 maj. Kryetarja e sindikatës Unia ishte folësja kryesore në Cyrih. Ajo theksoi se përpos grave edhe migrantët/et diskriminohen sistematikisht dhe kërkojnë të drejtë të njëjta për të gjithë.

## Të luftojmë bashkërisht

Është e nevojshme të luftohet më tej: për Kontrata të mira kolektive të punës, paga korrekte, pensione të sigurta për të gjithë, për pajtueshmëri e balancë të familjes dhe profesionit, mbrojtje më të mirë nga shkarkimi prej punës, veçanërisht për punonjësit e shtyrë në moshë, apo për digjitalizim social.

## 1 maji në Kosovë

Me moton «Qeveri boll më, Zbato Ligjet», punëtorët protestuan në shënimin e ditës ndërkombëtare të tyre 1 Maji. Protesta e mbajtur në Prishtinë, është thirrur nga Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK), e mbështetur edhe nga grupet sindikaliste dhe përparimtare si dhe një grup nga sindikata Unia e Zvicrës. Kjo ishte protestë e shumëpritur e BSPK-së për 1 Maj, pasi që vitet e kaluara nuk ka pasur protesta të tilla. Në këtë manifestim punëtorët dhe protestuesit të solidarizuar kërkuar zbatim të ligjit dhe respektim të drejtave të tyre, ndërkaq përmes transparenteve edhe: barazi në përfitime për detyrime të njëjta edhe për qytetarët e Kosovës!; për një shoqëri të lirë e të barabartë! Protestës i ishin bashkangjitur dhe komuniteti artistik, për t'i shprehur në mënyre kreative pakënaqësitë e tyre. Kryetari i BSPK-së Avni Ajdini, tha se përmes kësaj proteste, ata po

kërkojnë nga Qeveria zbatimin e ligjit për punëtorët, paga të dinjitetshme, ngritjen e pagës minimale në 250 euro, siguri në punë dhe zbatim të kontratës kolektive. Ndërsa Shukrie Rexhepi, kryetare e rrjetit të gruas së BSPK-së kërkojnë të drejtë për gratë në Kosovë dhe trajtim të barabartë me burrat.

## Solidariteti mes sindikatave në vepër

Pas saj, në fjalën e tij të rastit, përfaqësuesi i sindikatës Unia, një grup i së cilës kishte udhëtuar enkas për në Kosovë për tu solidarizua me këtë protestë, theksoi hendekun e madh mes të pasurve dhe të varfërve, adresojë kërkesat për ndarje më të drejtë dhe për financim të shëndetit dhe arsimimit publik, dhe jetesës me dinjitet për të gjithë, edhe për pensionistët, pavarësisht vendit ku ata kalojnë moshën e tretë.

Osman Osmani



Pamje solidariteti me protestën e 1 majit në Prishtinë

## 16 qershor 2018: Demonstratë për të drejtën e Azilit me dinjitet Për një shoqëri të angazhuar dhe të hapur

Me 16 qershor mbi 60 organizata thirrin demonstratën mbi regjionale «Mes nesh s'ka kufij». Ato ftojnë të gjithë të manifestojnë kundër racizmit dhe kundër tendencave represive e armiqësore karshi të huajve që nga rafshet ndër njerëzore deri tek ato ndërkombëtare!

Luftërat e vjetra dhe të reja janë duke shkretuar edhe më tej regjione të panumërta të kësaj bote, dhuna dhe varfëria detyrojnë me miliona njerëz të arratisen. Kufijtë zhvendosen sa më larg që është e mundur dhe deti Mesdhe në varrezë masive. Në Zvicër, njerëzit janë të indinjuar për tregtinë me skllëvër në Libi dhe njëkohësisht janë të kënaqur me numrin në rënie të kërkesave për azil.

## Presioni në rritje ndaj refugjatëve

Presioni në njerëzit që janë në arrati po rritet. Qendrat federale edhe më shumë po përkeqësojnë marrëdhëniet mes popullatës dhe azilkërkuësve dhe shumë janë të shtyrë në izolim. Statusi i përkohshëm F mban me mijëra veta në pasiguri afatgjatë dhe pengon

jetën e pavarur në Zvicër. Mocioni i iniciuar nga e djathta «Për një legjislacion koherent për personat pa letra» i cili është paralajmëruar për sesionin parlamentar të verës, synon tu heq të drejtën personave pa letra, si atë për sigurim shëndetësor dhe shkollim të fëmijëve të tyre. Në Kantonet, si Cyrihu apo Gjeneva, ku për ndihmën elementare përdoren strategji represive, për të detyruar njerëzit të largohen nga vendi.

## Zvicra dëbon për në vendet e BE-së

Zvicra feston në dhjetor 10 vite të anëtarësisë në Dublin dhe në këtë 10 vjeçar ajo ka ndërmarrë 30000 kthime në shtetet e BE-së. Edhe pse një nga vendet më të pasura të botës, Zvicra dërgon njerëzit që janë në arrati më

me dëshirë në vendet, të cilat ka kohë janë të sfiduara me këto probleme.

Me vdekjen e Mike, një person pa letra dhe anëtar i Kolektivitet Jean Dutoit në Lozanë, në muajin mars është personi i 5-të jo i bardhë, i cili brenda 18 muajsh vdes në duart e policisë. Ky rast është kulmi i pikëllimit.

Solidarité sans frontières

16 qershor, në ora 14, vendtakimi në «Schützenmatte», Bernë. Më shumë informata në: [www.sosf.ch](http://www.sosf.ch).

Mbështetja për financimin e demonstratës: <https://wemakeit.com/projects/demobusse-fuer-alle>

Marilia Mendes

# Aktivitetet për barazinë në paga Duhet dhënë fund diskriminimit në paga

Gratë janë të zemëruara dhe kjo në vitet e fundit ka rezultuar të jetë e mjaftueshme. Që nga demonstrata e fundit për barazi në paga e vitit 2015, kur 13 000 njerëz dolën në rrugë, u zhvillua një debat në rrjetet #SchweizerAufschrei, #metoo dhe #TimesUp. Pastaj marsin e kaluar përkohësisht nxori në pah: 15 000 njerëz me rastin e Women's March dolën në rrugë. Gratë janë të zemëruara: Ato angazhohen aktivisht dhe megjithatë nuk ndodh asgjë. Ignazio Cassis, nga regjioni i Tiçinos u zgjodh në bazë të kuotës në qeverinë federale dhe u pranua plotësisht në këtë funksion, mirëpo grave u mohohet sikur përfaqësimi ashtu edhe e drejta për të qenë të përfaqësuara. Gratë janë të zemëruara, pasi edhe zbatimimi i vonuar kohë të gjatë i së drejtës për pagë të njëjtë për punë të njëjtë, e drejtë kjo e sanksionuar që 37 vite në kushtetutë, u refuzua në fund të vitit nga këshilli i dhomës së përfaqësuesve të kantoneve. Këtë taktikë zvarritës, gratë nuk duan ta gëlltisnin më tej.

## Barazi në paga. Pikë. Fund.

Pasi ne gratë jemi të zemëruara, sepse ne po harrohem dhe anashkalohemi, edhe pse ne jemi njëra ndër lëvizjet më të fuqishme të këtij vendi. Andaj viti 2018 është edhe viti i barazisë në pagë – viti i grave: Prijës ishte 8 marsi, dita botërore e grave, me manifestime në gjithë Zvicrën.

Këshilli federal u paralajmërua me zë të lartë, që të merre seriozisht shqetësimet tona dhe të krijojë ligje të detyrueshme për punëdhënësit. Menjëherë më pas 1-Maji me moton: Barazi në paga. Pikë. Fund. Sepse nuk ka nevojë për diskutim të mëtejshëm, por respektim të barazisë në paga të mishëruar në kushtetutë.

## Barazi në paga – tani! Të gjithë në demonstratën e 22 shtatorit

Me 14 qershor, në ditën e grevës së grave, ne do të jemi prezent përmes aksioneve luftarake në të gjitha regionet. Aktivizmi ynë do të zgjatë nga mëngjesi i hershëm deri në mbrëmje. Ne do të fillojmë me aksione të vogla herët në mëngjes dhe do të përfundojmë me aksione të mëdha ku do jenë të nevojshme të gjitha aktivistet, që ti vejmë nën presionin e duhur punëdhënësit dhe zotërinjtë politikanë. Në vitin tonë do të arrijmë majën me demonstratën e madhe për barazi në paga me 22 shtator nën moton Enough (Mjaft) – pasi ne ka kohë të gjatë që jemi të zemëruara dhe më në fund duhet të dëshmojmë veprat. Pra. Eja edhe ti me 22 shtator kur do të thërrasim: Ne kemi pritur mjaftueshëm: Barazi në paga – tani!

Kathrin Ziltener & Virginia Köpfl



Pamje nga një manifestim i sivilizimit në Bernë për barazinë e pagave për gra

# Referendumi kundër mbikqyrjes të të siguruarve Jo monitorimit të personave të siguruar

Në muajin mars parlamenti i Zvicrës ka miratuar një ligj të ri sigurimi, që lejon mbikqyrjen në masë të panjohur deri më tani, të personave që marrin asistencë sociale. Unia kundërshton këtë mundësi mbikqyrjeje arbitrare dhe paragjyqese, andaj edhe mbështet referendumin kundër monitorimit të të siguruarve.



Mbikqyrja dhe observimi paragjyqes gjithandej

Përmes ligjit të ri, sigurimet shëndetësore, sigurimi pensional (AHV/IV, AVS/AI) dhe ai aksidental (SUVA) fitojnë më shumë kompetenca se sa policia: Rishtas lejohen video dhe audio incizime në sektorin privat, si dhe përcaktuesit e lokacionit përmes vendosjes së pulsuesve-GPS dhe si dhe dronët për të spiunuar personat e siguruar.

## Të gjithë të siguruar nën dyshim të përgjithshëm

Përmes këtij ligji e gjithë popullata vihet nën dyshim të përgjithshëm dhe sfera privat lëndohet në mënyrën më të vrazhdë. Aty ku me të vërtetë do t'ia vlen, për të parë qartë, parlamenti nuk i hedhë sytë fare: Ka vite që shumica e djathtë parlamentare pengon çdo nismë, për ndjekjen efikase të shmangieve të taksave, edhe pse është e njohur, se arkës së shtetit i ikin me miliarda.

## Arritje mjeshtrorë politike e koncerneve të sigurimeve

Parlamenti iu përkul lobimit masiv të korporatave të sigurimit deh miratoi ligjin, i cili u lejon detektivëve privat, pa aprovimin e gjyqtarëve që të përgjojnë në dhomat e banimit dhe në ballkone. Kësaj Unia i thotë qartë JO!

## E papranueshme në bazë juridike dhe kushtetuese

Edhe kryesia e Bashkimit të Sindikatave të Zvicrës (SGB/USS) ka vendosur që të mbështes referendumin e iniciuar kundër revidimit të Ligjit federal mbi pjesën e Përgjithshme të Sigurimeve Shoqërore (ATSG / LPGGA) dhe rregullat e parapara mbi observimin e të siguruarve.

Osman Osmani

## Intervistë

Kathrin Ziltener



## Shfrytëzimi i praktikantëve

Si sekretare për rini Kathrin Ziltener përfaqëson interesat e të rinjve ai brenda ashtu edhe jashtë sindikatës Unia. Rinisë së Unia-s i përkasin të gjithë anëtarët nën moshën 30 vjeç, veçanërisht ata që gjenden në arsimim profesional.

### Çilat janë format e praktikës?

Fillimisht duhet të bëhet dallimi mes praktikës dhe provës së vendit të arsimimit profesional. Të fundit shërbejnë për të mbështetur përzgjedhjen e profesionit dhe zgjat vetëm pak ditë. Me praktikën, Unia e të rinjve nënkupton një aktivitet ekonomik të kufizuar në kohë me karakter arsimor dhe përkufizim përkatës të qëllimit.

Ekzistojnë tre kërkesa të ndryshme të praktikës: Praktika para fillimit të arsimimit profesional, praktika obliguese gjatë apo para arsimimit profesional/studimeve, praktika pas arsimimit profesional/pas studimeve. Para së gjithash nga shfrytëzimi janë të prekura kategoria e parë dhe e tretë.

### Cili është qëllimi i praktikës dhe si është e rregulluar ajo me ligj?

Një praktikë i shërben qartë nxënies së përvojave praktike në një profesion ose fushë profesionale, pra është pjesë e shkollimit profesional dhe paraqet një plotësim krahas arsimimit teorik. Kjo është arsyeja pse «praktikat e detyrueshme» janë më pak shqetësuese nëse respektohen korniza e kushteve përkatëse.

Tek praktika para arsimimit profesional, puna qëndron ndryshe. Këto nuk janë më të parapara që nga futja e EFZ-së (Dëftësës federale të aftësisht). Ata paraqesin një sulm ndaj sistemit të arsimimit të dyfishtë, pasi si të tilla minojnë arsimin profesional. Praktikantët/et shpesh angazhohen si fuqi e lirë pune, pjesërisht me qëllim të sigurimit të një vendi trajnimi (arsimimi profesional).

Praktikantët/et, të cilët/at bëjnë praktikën pas arsimimit profesional, apo studimeve, e që shkak i mungesës së përvojës nuk gjejnë vend pune. Andaj kalojnë në një praktikë, shpesh të ndjekur nga praktikë një tjetër.

Përpos ligjit të punës nuk ka mbrojtje tjetër për praktikantët dhe praktikantet. Andaj Unia e të rinjve angazhohet për kushte të detyrueshme arsimimi të praktikantëve e praktikanteve të kësaj kategorie të fundit. Për praktikën para arsimimit profesional, Unia e të rinjve kërkon ndalesë, pasi që nga futja e EFZ-së ato kanë përfunduar si të panevojshme.

### Shumë ndërmarrje angazhojnë praktikantët e praktikante si fuqi të lirë pune. Përse nuk vepron politika?

Praktikantët/et angazhohen si fuqi e lirë pune, për të kursyer në kurrriz të personelit të kualifikuar dhe politika nuk vepron. Punëdhënësi nuk obligohet, që të paguajë një pagë. As edhe karakteri arsimor nuk garantohet. Punëmarrësit e rinj kanë nevojë për një vend pune edhe duke qenë në djeni, që fjala është për një fazë kalimtare, nuk organizohen në sindikatë.

### Çka ka ndërmarrë Unia e të rinjve dhe partnerët e saj dhe çka pritet në të ardhmen?

Unia e të rinjve momentalisht është duke u angazhuar bashkë me rininë socialiste të Zvicrës dhe provon që tërheqë vëmendjen për problematikën përmes aksioneve publike. Aksioni i parë në Benë vetëm sa është zhvilluar: Praktikantët e praktikantët janë fshikulluar me kamxhik përgjatë pjesës së brendshme të qytetit të Bernës, duke simbolizuar kështu shfrytëzimin nga punëdhënësit. Ne jemi duke u përpjekur bashkë me shërgjertët/et dhe praktikantët/et të tërheqim vëmendjen për problematikën në fjalë dhe kemi një apel të qartë për politikanët: rregullimi i ligjor i të gjitha formave të praktikës dhe një ndalesë të para – praktikës!

Osman Osmani

## Ju pyesni, Unia përgjigjet

### Përfitimet e përditshme në rast sëmundjeje: Firma nuk më paguan rogon, çka mund të bëjë?

Unë punoi qe dy vite për një dyqan kasapi. Para tre muajsh jam sëmurë. Se kur do të mund të punoi përsëri, unë ende nuk e di. Firma ka probleme financiare. Që nga koha e sëmundjes unë nuk kam marrë më rogë. Në kontratën time punës qëndron se është lidhur një kontratë sigurimi i përfitimt të përditshëm në rast sëmundjeje. Shefi im ngul këmbë, se ai mund të më paguajë rogon, tek pasi të paguajë sigurimi i pagës së përditshme në rast sëmundjeje, gjë që sigurimi ende nuk e ka bërë. Një koleg më ka thënë se unë mund të kërkoj nga sigurimi në fjalë, që të mi paguajë drejtpërdrejtë paratë e përditshme. A qëndron kjo?

**Regula DICK:** Po. Ju keni të drejtën personale ligjore karshi sigurimit të parave të përditshme në rast sëmundjeje. Ju mund të kërkonj, që tu paguhen juve drejtpërsëdrejti paratë e përditshme. Punëdhënësi juaj në të vërtetë është i obliguar t'ju tregoj juve emrin e sigurimit në fjalë. Drejtojuni sigurimit në fjalë me një shkresë rekomande. Ia komunikoni asaj se punëdhënësi juaj nuk është duke ua paguar paratë e përditshme të siguruar dhe kërkonj nga sigurimi që, paratë tua paguajë juve drejtpërsëdrejti. Shkresës suaj duhet t'ia bashkëngjiti vërtetimin e mjekut mbi sëmundjen tuaj dhe në të ardhme dërgojani atë si punëdhënësit ashtu edhe sigurimit.

Work, 16 mars 2018

### Regjistrimi i kohës së punës: A lejohet intervali 15 minutash?

Unë punoi nga e hëna deri të premten përherë nga ora 8 deri në ora 14 në një Callcenter (qendër thirrjes telefonike). Vula e orës së kartelës sonë të punës përfshin një kohë punë me interval 15 minutash. – Nëse unë vonohem, fjala bie në ora 8:01, kështu mua regjistruesi i kohës së punës sonë më gjobon sikur unë të kem vulosur kartën e fillimin të punës në ora 8:15. Mirëpo nëse unë punoi 10 minuta më gjatë, kështu sistemi i regjistrimit ma shlyen këtë kohë normale të punës që bëhet pas përfundimit të orarit të punës. A lejohet kjo?

**Igor Zoric:** Jo. Punëdhënësi duhet të regjistroi kohën e punës ashtu sikur edhe është punuar faktikisht. Koha e punës sipas ligjit të punës është koha, në të cilën njeriu është në dispozicion të punëdhënësit. Posa të keni vulosur kartelën tuaj të punës, atëherë jeni në punë. Për të pasur mundësinë zyrtarët përgjegjës që të kontrollojnë se a respektohet ligji në një ndërmarrje, duhet që koha e punës të regjistrohet me përpikëri. Pos kësaj duhet, shembulli bie që koha ditore dhe ajo javore punës, orët e tepërta si dhe pauzat mbi gjysmë ore të jenë të dëshmuara. Manipulimet me rastin e regjistrimit të kohës së punës janë të ndaluara. Edhe atëherë kur orët e tepërta të punës sipas kontratës së punës mund të kompensohen në mënyrë paushallë me pushime shtesë apo pagë më të lartë të orëve të tepërta, megjithatë ato duhet të regjistrohen me përpikëri.

Work, 13. April 2018



## Konferenca «Diaspora flet» 17–20 maj 2018 në Prishtinë Dialogu për të Drejtat e Diasporës

Konferenca katër ditore Diaspora Flet u mbajt për herë të parë në këtë format në Kosovë si pjesë e nismës për Dialogun e Strukturuar për të Drejtat e Diasporës, që u organizua nga organizata joqeveritare Germin. Ajo ka arritur të bashkojë afro 170 pjesëmarrës, që të gjithë profesionistë të fushave të ndryshme nga diaspora shqiptare, me origjinë nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia së bashku me përfaqësues të institucioneve publike të këtyre tre vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Fjalimi kryesor në ceremoninë hapëse të Diaspora Flet u mbajt nga eksperti i njohur ndërkombëtar për çështje të diasporës Kingsley Aikins, themelues dhe drejtor ekzekutiv i Diaspora Matter, njeriut që ia mblodhi Irlandës 250 milionë dollarë në Fondin për Irlandën, nga rrjetëzimi i profesionistëve nga diaspora, dhe me qëllim të rimëkëmbjes së Irlandës gjatë problemeve të saj me veriun. Në këtë konferencë morri pjesë edhe një delegacion nga Zvicra, i përbërë kryesisht nga sindikalistë shqiptarë që veprojnë në kuadër të sindikatës Unia si dhe aktivist/e politik/e shqiptaro-zviceranë.



**Kontribut i sindikalisteve/ëve shqiptarë të Unia**  
Në kuadër të kësaj konference sindikalistët e Unia-s në marrëveshje me Germin dhe në bashkëpunim edhe e me BSPK (Bashkimin e Sindikatave të Pavarura të Kosovës) zhvilluan aktivitete rreth botës së punës në Kosovë. Në ditën e dytë të konferencës, më 18 maj, në lokalin Orion të Prishtinës u zhvillua punëtorja «Siguri dhe mbrojtja e shëndetit në punë» ku morën pjesë përfaqësuesit e degëve të BSPK-së, Inspektorati i Punës në Kosovës dhe të interesuar të tjerë. Ndërsa në të dytën me sindikalistët e Unia zhvilluan një bashkëbisedim me përgjegjësit e BSPK-së mbi reformat e mundshme sindikaliste në Kosovë dhe shtjelluan ide të ndryshme bashkëpunimi të mundshëm mes të dy sindikatave.



**Kontributet tjera të aktivisteve/ëve shqiptaro-zviceranë**  
Gjatë katër ditëve të konferencës u zhvilluan panele të ndryshme në të cilat aktivistë shqiptaro-zviceranë dhanë kontributin e tre në trajtimin e temave si: Migrimi qarkor; Mobilizimi i diasporës për zhvillim; Sfidat e diasporës gjithandej, etj. Edhe këtu sikur në panelet e punimet tjera të kësaj konference nuk mbeti pa u përmendur diskriminimi i shkaktuar nga Marrëveshja e dështuar ndërshtetërore e Sigurimeve Shoqërore mes Zvicrës dhe Kosovës.

**Askujt nuk i hyn në punë një komunitet i përçarë!**  
Ndërkaq në përmbyllje të Konferencës, në oborrin e Ministrisë së Kulturës (ku mungoi së paku një përshëndetje nga njerëzit që drejtojnë kulturën!), Liza Gashi duke falënderuar pjesëmarrësit dhe ekipin e saj të vyeshëm, potencoi se po bëhen përpjekje që diaspora jonë dinamike gradualisht po strukturohet ndaj edhe po shtohen përpjekjet nga ana Germinit që të gjenden modele sa më të përshtatshme dhe se konferencat e kësaj natyre mund të organizohen nëshër edhe në Greqi, Finlandë apo vendet tjera, kudo që jeton dhe vepron mërgata jonë. Por që të jemi sa më të suksesshme të bëjmë përpjekje, që mos ti shtymë interesat personale para se ato grupore, sepse askujt nuk i hyn në punë një komunitet i përçarë nga ego të ndryshme.

**Për një bashkëpunim të mirëfilltë ekspertësh**  
Ndaj edhe tash shtrohet pyetja para se paratë e mërgatës si ti vejmë në funksion në vendet e prejardhjes gjitha ato aftësi e përvoja dhe si të gjemë gatishmërinë e institucioneve përkatëse që disa nga ata ekspert qoftë edhe përkohësisht ti kthejmë në Kosovë, duke krijuar një klimë më të favorshme për ta. Përpjekja tjetër duhet të jetë që edhe atë kuadër ekspertësh që kem në Kosovë ta mbështesim me vende adekuate të punës, e jo si të bëjmë përpjekje që përmes «shpejtitimit» të vizave ta nxjerrim jashtë, derisa familjet e tyre kanë harxhua edhe lekun e fundit për shkollimin e tyre. Me një fjalë ti vejmë në binarë bashkëpunimi ekspertët tanë nga mërgata me ata vendas.  
Me një fjalë si ta ndryshojmë realitetin që ajo diasporë që foli gjatë kësaj konference në Kosovë, por që vepron në diasporë të gjejë një ngrohtësi më të madhe tek institucionet e vendit, siç e gjeti tek Germin, veprues e shpresëdhënës.

Rexhep Rifati & Osman Osmani

### Je duke punuar në gastronomi apo në pastrim dhe dëshiron të arsimohesh më tej?

#### Progredir – arsimimi profesional për migrant/e në gastronomi dhe në pastrim:

- Ti je duke punuar me vite në gastronomi apo në pastrim?
- Ti dëshiron ti thellosh njohuritë tua gjuhësore dhe aftësitë tua profesionale?
- Ti dëshiron të arrish një certifikatë të aftësisë profesionale në gastronomi apo pastrim?

#### Je i/e interesuar? Eja në tubimin tonë informues! Të shtunën, 30 qershor 2018, në ora 10.30

Unia Neuchâtel, 2e étage, av. Gare 3, 2000 Neuchâtel

Lajmërimi dhe informata të mëtejme mbi tubimin informues tek  
Unia Neuchâtel, Isabel Amián, T 079 388 39 48, isabel.amian@unia.ch, www.progredir.ch

